

community

The New Apostolic Church around the world

01/2015/AI



Motoja e vitit 2015:

Gëzim në Krisht

Prova, Ndryshime, Fillim i ri:
Shërbesa fetare në
Luksemburg

Katekizmi, botim i
shkurtuar: Pyetje dhe
Përgjigje

New Apostolic Church
International



Në të gjithë botën

Të dashur bashkëbesimtarë në të gjithë botën,

është gëzim për mua t'ju prezantoj revistën e re ndërkombëtare të anëtarëve të Kishës Apostolike të Re: „Community“, botimin e parë të së cilës sapo e lexoni. Që nga kjo kohë ajo do të botohet çdo tremujor dhe do të arrijë e shtypur ose me anë të internetit brënda mundësive në çdo familje apostolike.

Titulli në gjuhën Angleze „community“ është një program i trefishtë.

- **Komunikim** (*anglisht: communication*): Revista e re e anëtarëve të kishës duhet të japë ndihmesën e saj, që informacione të rëndësishme – qofshin këto shërbesa fetare, mësim, ngjarje aktuale ose zhvillime fetare – t'ju arrijnë ju, të dashur motra dhe vëllezër, sa më shpejt të jetë e mundur.
- **Unitet** (*anglisht: unity*): Ne kemi një besim dhe një qëllim. Prandaj është me rëndësi, sikurse dëgjojmë në shërbesa fetare, që mundësisht të jemi të gjithë në të njëjtin stad të jetës së përditshme, si në teori edhe në praktikë. Kështu, ne duam të forcojmë themelin, bazën e Kishës ndërkombëtare dhe të nxisim unitetin.
- **Bashkësi** (*anglisht: community*): Ne jemi një bashkësi ndërkombëtare me ndryshime të kushtëzuara shoqërore dhe kulturore. Informacionet rreth jetës shumëngjyreshe të bashkësive në të gjithë globin do të ndihmojnë që ta njohim dhe të kuptojmë më mirë njëri-tjetrin. Kështu bashkësia ndërkombëtare duhet të qëndrojë dhe të rritet sëbashku më shumë se deri tani.

Dikujt nga ju, ndoshta do t'i mungojë botimi i revistës me titullin „Familja jonë“ në gjuhën e tij. Por ne kemi konstatuar se në këtë mënyrë nuk arrinim aq shumë motra e vëllezër të besimit



NAK International

si në dekadat e fundit. Për këtë arsye, mbledhja e apostujve të distriktit, në vjeshtën e vitit 2013 në Kanada, ka vendosur një koncept të ri komunikimi. Këtu, krahas revistës së anëtarëve „community“ edhe revista e lajmeve në internet nac.today, do t'i furnizojë çdo ditë ata me të reja nga bota apostolike e re.

Uroj që këto të reja të forcojnë dhe të ndihmojnë – duke i qëndruar besnik motivit aktual për këtë vit – „Gëzim në Krisht“, për t'ju afruar sado pak qëllimit tonë të përbashkët. Shpresoj dhe dëshiroj që edhe pse nuk mundët ta merrnit revistën që në fillim të vitit, të kenë në muajt e ardhshëm një gëzim të madh, rritje në frymën e Krishtit dhe bekimet e më të Lartit.

Juaji Jean-Luc Schneider

Prova, Ndryshime, Fillim i ri



Fotot: Marcel Feldb



Shërbesa fetare e 11 Janarit 2015 në Luksemburg

Fjala nga Bibla, Romakët 12,2

“Mos lejoni që t’ju kushtëzojë bota. Përkundrazi, pranoni të shndërroheni plotësisht. Pranoni t’i jepni vetes një pikëpamje të re. Atëherë do ta kuptoni çfarë kërkon Perëndia prej jush. Atëherë do ta dini çfarë është e mirë dhe e përsosur dhe çfarë i pëlqen Perëndisë.” (Rom 12, 2)

Të dashur motra e vëllezër, miq të nderuar, të bashkësisë këtu dhe ju që jeni lidhur me këtë transmetim. Unë gëzoj, që munda sot të jem në Luksemburg, pranë motrave dhe vëllezërve të mi dhe që sëbashku mundëm të hedhim një hap më përpara në këtë vit, i cili duhet të jetë edhe viti i gëzimit tonë në Krisht. Disa më kanë shkruar dhe më kanë informuar: „Viti i gëzimit ka filluar me të vertetë „mirë“. A s'po e sheh se çfarë po ndodh?“ Por, të dashur motra e vëllezër, unë përsëri e them: Ne dëshërojmë edhe këtë vit të gëzojmë në Krisht. Dhe ne kemi mundësi ta bëjmë këtë. Së pari, sepse Perëndia ynë i dashur dëshëron të na dhurojë diçka herë pas here, për të cilën ne do të gëzojmë edhe pse do të kemi ditë të vështira, dhe këto i kemi përpara. Secili prej nesh ka pasë një herë një ditë të vështirë – edhe në këtë vit.

E megjithatë ne mundemi të gëzojmë. Kjo nuk ka të bëjë aspak me gazin e harenë, me falenderimin dhe lavdërimin, por ne mund të përjetojmë se Zotin e kemi pranë, e pikërisht në këtë kohë prove. Dhe ky është një gëzim i veçantë, kur vemë re se Perëndia yt i dashur është krejtësisht pranë teje.

Ne kemi gjithnjë një arsye për t'u gëzuar – në ditë të mira dhe në ato pak më të mira –, se vetë Jezusi ka thënë: „Gëzoni më tepër që emrat tuaj janë shkruar në Qiell“ (nga Luka 10,20). Ne folëm dje edhe me fëmijët rreth asaj se çfarë është qielli. Qe një diskutim shumë interesant. Tani nuk dua t'i kthehem kësaj. Ju mund ta vrisni vetë mendjen rreth kësaj gjëje. „Gëzohuni që emrat tuaj janë shkruar në qiell.“ Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se Zoti Jezus vdiq për ne, që ne e kemi të lirë rrugën për tek Zoti. Ai ka shkruar përpara nesh: „Dhe kur të shkoj e t'ju përgatis një vend, do të kthehem përsëri e do t'ju marr pranë vetes, që aty ku jam unë, të jeni edhe ju“ (Gjoni 14,3). Si mund të imagjinohet kjo? Jua kam thënë nganjëherë edhe fëmijëve, kjo është shumë e lehtë: Në disa ngjarje, për shembull në një shërbesë të madhe fetare, dërgon dikë më parë dhe i thua: „Ma zër dhe mua një vend!“ atëherë ai vendos librin e këngëve, një çantë apo diçka tjetër mbi atë vend. E kur vjen dikush i thuhet: „Eshhtë i zënë!“ „Po si?“ – „Po, është për shokun tim!“ Ja ruan vendin atij. Dhe kur vjen ai që ti njeh, i thua: „Ky është vendi yt!“ E pikërisht këtë ka bërë Jezusi për ty. Ai është kthyer tek Ati i tij dhe mban për ty dhe për mua një vend të lirë dhe thotë: „Ky është vendi i vëllait tim, ai atje është vendi i motrës sime, ky është për ty, ai është për të.“ Emrat tanë janë shkruar në qiell, sepse Zoti Jezus ka parashikuar për secilin prej nesh një vend në bashkësinë me Zotin. E po të mendosh kështu, ke gjithnjë një shkak, një arsye për t'u gëzuar.

Tashmë ju lexova një fjalë shumë të vjetër por edhe shumë bashkëkohore. Pali u shkroi Romakëve: „Mos lejoni që t'ju

kushtëzojë bota. Përkundrazi, pranoni të shndërrohëni plotësisht ...“ Tek fjala „bota“ mendon njeriu menjëherë tek ligësia, tek njerëzit e këqij e tek gjithçka tjetër. Këtu nuk bëhet fjalë për këtë. Këtu bëhet fjalë për kohën, për kohën e shpirtit. Pali do të tregojë me këtë: Nga njëra anë kemi Perëndinë e Gjithpushtetshëm, i cili nuk ndryshon kurrë. Nuk ka përse të ndryshojë, ai është vetë përsosmëria. Ai nuk ndryshon as edhe nën presionin e ngjarjeve të kohës. Sjellja dhe vepra e tij

nuk influencohen nga ajo që ndodh në botë. Ky është Perëndia. „Unë jam Zoti, nuk ndryshoj“ (Malakia 3,6).

Nga ana tjetër ne kemi kohën e shpirtit si shprehje e asaj, që njerëzimi është gjithnjë në ndryshim. Lërmëni të prek vetëm dy pika rreth kësaj: marrëdhënia me Perëndinë

„Emrat tanë janë shkruar në qiell, sepse Zoti Jezus e ka parashikuar për secilin prej nesh një vend në bashkësi me Perëndinë.“

dhe marrëdhënia me tjetrin, me të afërmin. Ato ndryshojnë vazhdimisht. Kur çdo gjë shkon mirë e është në rregull, nuk ja ke gjithnjë nevojën Zotit. Kur nuk po të ecën mirë, atëherë vrapon për tek ai: I dashur Zot, më ndihmo! Në varësi të sjelljes së tjetrit, e se çfarë po ndodh në botë, ndryshojnë edhe marrëdhëniet midis njerëzve. Ndonjëherë është gjithçka mirë e bukur dhe një herë tjetër është i afërmi apo tjetri armiku yt më i madh. Ka një ndryshim të vazhdueshëm. Në varësi të ngjarjeve që ndodhin në tokë ndryshon edhe marrëdhënia kundrejt Zotit dhe tjetrit, ndryshojnë mendimet dhe lidhjet kundrejt së vërtetës. Pali thotë: „mos lejoni që t'ju kushtëzojë bota por kontrolloni, se cili është vullneti i Perëndisë.“ Ai kërkon prej nesh: referojuni Perëndisë, me fjalë të tjera: mos lejoni t'ju marrë fryma e kohës! Lidhja jonë me Zotin duhet të mbetet e pandryshuar. Lidhja jonë me tjetrin nuk duhet të influencohet nga ajo, që po ndodh në botë. Pika jonë e referimit është Perëndia. Ne i referohemi atij, asaj që ai kërkon, asaj që ai thotë; e vërteta e tij është e vërteta jonë. Ne nuk influencohemi nga opinionin e shumicës. Edhe kur bota e sheh këtë çështje krejtësisht ndryshe, ne duhet të themi: „Na vjen shumë keq! Ne i referohemi Zotit, dhe urdhëresa e tij nuk ka ndryshuar. Nuk mund të bëjmë dot asgjë.“ Edhe sikur të mbesim një tufëz e vogël, gjë që nuk jemi – ne e quajmë veten të krishterë, si njerëz besimtarë ndaj Zotit. Kështu që nuk mund të themi: Por të gjithë veprojnë kështu apo të gjithë e shohin këtë gjë ashtu! Jo, Pali thotë, ju duhet ta provoni vetë, mbetet nën përgjegjësinë tuaj. Për marrëdhënien time kundrejt Zotit, kundrejt të afërmit, tjetrit jemi vetë përgjegjës. Është detyra ime të provoj: a puqet ajo që them, ajo që bëj me vullnetin e Zotit?

„Kontrolloni, se cili është vullneti i Perëndisë ... domethënë e mira.“ Çfarë është e mira? Pali thotë: E mira është ligji i Perëndisë, urdhëresat, që Zoti i dha Moisiut (Rom 7,12). Nëse

Apostul Jens Lindemann
(Hessen/Rheinland-Pfalz/Saarland)
gjatë mbajtjes së fjalës së tij



ketë bota e quan të drejtë ose jo, për ne kjo është pika e vetme e referimit. Ajo është gjithnjë e vlefshme. Ndër ligjet bën pjesë edhe ligji i dashurisë. „Ti duhet të duash Perëndinë“, dhe „të duash të afërmin, tjetrin si veten tënde“. Jezusi ka shpjeguar shumë qartë se çfarë do të thotë ta duash të afërmin si veten tënde. Ai ka thënë: „Gjithçka, pra, që doni t’ju bëjnë njerëzit juve, kështu duhet t’ua bëni edhe ju atyre!“ (Mateu 7,12). Nuk ka ku shkon më thjeshtë. Kjo vlen për të gjitha kohërat dhe në të gjitha rrethanat, edhe sot, në 2015, në Europë, në Afrikë, në Amerikë. Ne duhet gjithnjë të kontrollojmë veten: a është akoma kështu? A veprojmë unë kështu? A kam po këtë mendje? Çfarë është e mirë? I mirë është ligji i Perëndisë, dhjetë urdhëresat, ligji i dashurisë ndaj Zotit dhe ndaj të afërmit tënd.

Kur më poshtë shkruhet: „Kontrollo, cili është vullneti i Zotit ... domethënë ajo që i pëlqen atij“, atëherë duhet të vrasim mendjen se çfarë i pëlqen me të vërtetë Zotit.

Nxënësit e tij mendonin shpesh se vepronin ashtu siç Jezusi e priste prej tyre, por gabonin. Zotit i duhej t’u thoshte: Jo kështu! Nxënësit e tij e kuptuan se cila ishte detyra e tyre. Detyra ishte që të vepronin sipas ligjit. Detyra e tyre ishte t’i shërbenin Perëndisë. Detyra e tyre ishte të shpallnin dhe ta mbronin besimin. Kështu ata e kuptuan detyrën e tyre e çdo gjë shkoi në rregull. E megjithatë ata nuk kanë vendosur gjithnjë prioritetet e duhura. Kujtoni Pjetrin. Ai e kish kuptuar se duhet të mbronte Zotin e tij. Por kur luftëtarët erdhën për ta kapur Zotin, mësuesin e tyre, ai nxori shpatën dhe i preu veshin njërit prej tyre (Gjoni 18,10). Në atë rast iu desh Jezusit të thoshte: Jo, nuk është kjo, ajo që pëlqej. Nuk duhet të më mbrosh kështu! Përfundimi: Zotit nuk i pëlqen fare, kur ne për hir të shpalljes apo mbrojtjes së besimit tonë të dëmtojmë, të lëndojmë tjetrin. Këtë duhet ta përmendim shumë shpesh në shoqërinë e sotme. Kjo gjë nuk i pëlqen Perëndisë. Kjo vlen edhe për ne.

Një herë tjetër Gjoni erdhi pranë Zotit dhe tha: „Mësues pamë një njeri që dëbonte shpirtra të këqinj në emrin tënd. Ne u përpoqëm ta pengonim, sepse nuk i takon rrethit tonë“ (Marku

9,38). Gjoni ishte i zemëruar, por Zoti i tha: „Mos e pengoni më [...] Kush nuk është kundër nesh, është me ne!“ (Marku 9,40). Unë mendoj se kjo e habiti Gjoni, i cili ishte shumë i sigurt se kish bërë diçka të mirë. Ndoshta kish pritur veç një lavdërim nga Zoti: Ke vepruar shumë mirë! – por Jezusi e pa në një tjetër mënyrë.

„Perëndisë nuk i pëlqen kur ne, për ta shpallur apo për ta mbrojtur besimin tonë, lëndojmë të afërmin.“

E kam menduar shpesh këtë ngjarje. Është dikush që nuk ndjek pas Jezusit. Nuk e ka parë Jezusit si birin e vetë Perëndisë, megjithatë ai dëshironte të bënte mirë dhe në fakt bënte mirë, pasi ndihmonte

bashkohësit e tij. Ai kishte dëbuar shpirtra të këqinj, pra kryente mrekulli. Duket qartë se Perëndia ishte me të dhe e kish përdorur atë si mjet për të kryer të mira ndaj të tjerëve, megjithatë ai nuk e ndiqte pas Jezusit. Dhe Jezusi tha: Është në rregull kështu!

Në këtë botë janë të shumtë njerëzit që nuk e ndajnë me ne



**lart: këngëtarët e korit miks
majtas: Apostul Rudolf Kainz (Austri) gjatë shërbimit**

ndonjë shpikje e imja, kjo rrjedh nga vetë fjala e Perëndisë.

Ky respekt nuk ndryshon asgjë në besimin tonë. Ne besojmë në Jezu Krisht. Ndjekim rrugën, e cila është menduar për shpëtimin tonë. Besojmë në rikthimin e Krishtit si dhe tek posti, detyra e apostujve. Por për këtë ne nuk duhet të përbuzim të tjerët, duke ditur se Perëndia mund të punojë edhe me njerëz të tjerë, i ndihmon, i bekon dhe ata mund të bëjnë të mira. Perëndisë i pëlqen nëse ne i respektojmë ata.

Një herë tjetër Gjoni, kur pa se Jezusi nuk u pranua në Samari tha: „Zot, a të urdhërojmë që të zbresë nga qielli zjarri dhe t'i shkatërrojë këta njerëz“ (Luka 9,54). Por Jezusi e qortoi atë. Nuk ishte i kënaqur. Ai nuk donte t'i detyronte njerëzit ta praninin atë, duke i kërcënuar: nëse nuk e pranoni, atëherë do të bjerë zjarr nga qielli!

Nuk është e pëlqyer nga Perëndia kur duam të motivojmë njerëzit me kërcënime e frikë. Ne duhet ta duam Perëndinë si dhe të afërmin tonë. Këtë urdhëresë duhet ta kuptojmë dhe

besimin, as nuk besojnë në Jezu Krisht, birin e Perëndisë. Prapëseprapë ata përpiqen t'i bëjnë mirë fqinjët dhe t'i shërbejnë Perëndisë. Zoti i përdor ata si mjet për të bërë të mira. Ai nuk do të ishte i kënaqur, nëse nuk do t'i vlerësonim ata, t'i përbuznim ose madje t'i sulmonim. Kjo nuk është

zbatojmë në mënyrën e duhur. Zoti Jezus e ka bërë të qartë: lidhja jonë ndaj Perëndisë është e lidhur ngushtë me lidhjen që kemi ndaj tjetrit. Njëra është e pandashme nga tjetra. Ai e ka sqaruar me fjalët: „Në qoftë se shkon në altar, që t’ia kushtosh dhuratën tënde Zotit, dhe atje të kujtohet se bashkëbesimtari yt ka diçka kundër teje, atëherë lëre dhuratën tënde aty para altarit, dhe shko pajtohu më parë me bashkëbesimtarin tënd. Pastaj mund t’i kushtosh Zotit dhuratën“ (Mateu 5,23,24). Njeriu nuk mund t’i shërbejë Perëndisë dhe njëkohësisht të përbuzë ose të jetë i armiqësuar me të afërmin. Dashuria ndaj Zotit dhe tjetrit janë të lidhura fort me njëra-tjetrën.

Edhe Jezusi qartëson, se nuk mund ta zgjedhim vetë të afërmin tonë. Kjo do të ishte e mrekullueshme! Unë vendos, se cilin do të dua. – Perëndia vendos, se kush do të jetë

djathtas: apostuli kryesor Jean-Luc Schneider me bashkëbesimtarët mbas shërbesës fetare

poshtë: gjatë shërbesës fetare këndon korri mik

i afërmi yt! I afërmi është pikërisht ai që është sëmurë, ai që është në burg – veç ta përfytyrojmë këtë! – dhe ai i huaj, i cili është shumë ndryshe nga ti, që ka një kulturë tjetër, një besim tjetër, një mendim tjetër (Mateu 25,35-40). Pikërisht atë duhet ta duash! Ti nuk mund ta vendosësh vetë, se cili do të jetë fqinji yt. I afërmi yt do të jetë ai, të cilin Zoti do vendosë të



jetë. Sigurisht – për aq kohë sa i huaji do të jetë në vëndin e tij, shumë larg, mund ta duam. Por tani ndoshta Zoti vendosi që i sëmuri, i varfri, i dënuari, i huaji, të jetojë pikërisht pranë teje, në fshatin apo qytetin tënd. Perëndia e donte kështu. Ai është tani i afërmi yt. Dhe tani kontrollo të lutem se çfarë i pëlqen Perëndisë!

Ne shohim se besimi ynë, besimi apostolik i ri, është diçka shumë konkrete. Ai bëhet shumë shpejt si diçka praktike. Atë të cilin Perëndia e ka vendosur në anën tonë, atë duhet ta duam.

Jezusi ka treguar se shërbimi ndaj tjetrit nuk mund të zëvendësojë shërbimin ndaj Perëndisë. Të dyja janë të lidhura ngushtë. Disa njerëz e mendojnë, se po i shërbyen tjetrit atëherë s'është e domosdoshme t'i shërbejnë Perëndisë. Kështu nuk shkon. Ju e dini, kur Maria solli një vaj të çmuar dhe ia vajosi këmbët Zotit, njëri nga nxënësit tha: „Përse nuk u shit ky parfum për treqind monedha të argjendta dhe paratë t'u ndaheshin të varfërve?“ Por Jezusi i tha: „Mos e shqetëso! Ajo e bëri këtë për ditën e varrimit tim. Të varfërit do t'i keni gjithnjë pranë jush, por mua do të më keni edhe për pak“ (Gjoni 12,1-8). Shërbimi ndaj tjetrit nuk e zëvendëson shërbimin ndaj Perëndisë. Njeriu duhet t'i bëjë të dyja. Kjo është e pëlqyeshme për Perëndinë.

„Kontrolloni, se cili është vullneti i Perëndisë ... pikërisht atë që është e përkryer.“ Perëndia është i përsosur, atij nuk i duhet të ndryshojë, atij nuk i duhet të përshtatet. Por ne jemi jo të përsosur dhe duhet ta vëzhgojmë vazhdimisht veten: Çfarë duhet të ndryshojë unë te vetja? Asgjë për t'u përshtatur me shpirtin e kësaj kohe, por vetëm për t'u matur me përsosmërinë e Perëndisë. Aty duhet të pyesim gjithmonë veten tonë dhe kjo vlen si për kishën ashtu edhe për çdo individ. Cili është vullneti i Perëndisë? Çfarë kërkon Zoti Jezus? Ndoshta ne duhet të përshtatemi pasi konstatojmë se Zoti ka ecur një hap përpara dhe se jemi të vetëdijshëm që nuk kemi kuptuar krejtësisht atë çfarë ai kërkon. Po kështu ndihej edhe Pjetri. Ai kujtonte se çlirimi ishte vetëm për Izraelin. Urdhri i parë i dërguar i përshtatet po kësaj: Shko te fëmijët e Izraelit – jo te Samaritanët! (Mateu 10,5). Por më pas Zoti i tregoi që të shkonte edhe te joçifutët. Aty ai duhet të ndryshonte mendim. Po kështu ndodh edhe në kishën tonë. Ne duhet të kontrollojmë vazhdimisht, nëse teoria jonë i përshtatet vullnetit të Perëndisë, apo nëse ajo ka nevojë për ndonjë ndryshim. Kur arrijmë të themi: po, tani e kuptojmë shumë më mirë Zotin Jezus, atëherë duhet të bëjmë ndryshime, duhet të përshtatemi, pasi konstatojmë se: ajo që ne kemi predikuar një herë nuk qe sipas vullnetit të Perëndisë. Nuk ishte e gabuar, por gjatë kësaj kohe kemi vënë re: Vullneti i Perëndisë ecën përpara. Këtij duhet t'i përshtatemi ne si njerëz të vegjël që jemi.

Dhe ajo që vlen për kishën, vlen për secilin prej nesh. Ne nuk mund të qëndrojmë te tradita dhe të themi: Kështu kemi vepruar gjithmonë. Ne gjithmonë duhet të pyesim veten: Si

qëndroj unë kundrejt Perëndisë, kundrejt tjetrit? Çfarë mund dhe çfarë duhet të ndryshojë? Jo fort e rehatshme edhe për mua - se nuk më pëlqen aq shumë, - por është e domosdoshme!

Për disa, ndryshimet mund të jenë shkak për mërzitje. Por për besnikët, të cilët e marrin seriozisht, është pikërisht ky ndryshim, kjo përshtatje, ky dyshim, ky kontroll i vazhdueshëm, një burim dhe një arsye për një gëzim të madh. Kështu krejtësisht thjesht, sepse Zoti Jezus do të na thotë: „Kjo më pëlqen !Unë të bekoj!“

Mendimet thelbësore

Marrëdhënia jonë kundrejt Perëndisë dhe tjetrit nuk duhet të influencohet nga ngjarjet e kohës dhe nga mjedisi. Ne drejtohem sipas vullnetit të Perëndisë, i cili pret prej nesh,

- që ne të duam Perëndinë dhe tjetrin.
- që ne të tregojmë tolerancë dhe ndaj tjetrit.
- që ne të jemi dakort për t'u përmirësuar, me qëllim që të fitojmë përsosmërinë.



Fotot: Oliver Rütten

Katekizmi në Pyetje dhe Përgjigje

„Një kishë, e cila harron mësimet e saja, është një kishë e dobët“ – kjo shprehje e apostulit kryesor në shërbesën fetare në Toulouse, bën të qartë edhe një herë, se sa me rëndësi është për apostulin që, të gjithë të krishterët apostolikë të ri, ta kenë të njohur teorinë, mësimet e besimit. Ai iu futi bashkëbesimtarëve në zemër të përpiqen për të njohur sa më shumë përmbajtjen e mësimëve të Kishës Apostolike të Re.

„Një kishë, e cila harron mësimet e saja, është një kishë e dobët“ – kjo shprehje e apostulit kryesor në shërbesën fetare në Toulouse, bën të qartë edhe një herë, se sa me rëndësi është për apostulin që, të gjithë të krishterët apostolikë të ri, ta kenë të njohur teorinë, mësimet e besimit. Ai iu futi bashkëbesimtarëve në zemër të përpiqen për të njohur sa më shumë përmbajtjen e mësimëve të Kishës Apostolike të Re.

Vetëm ai që i ka bërë të vetat keto mësimë, është në gjendje t'i përçojë ato më tutje. Megjithatë, nuk mjafton vetëm t'i

njohësh këto mësimë, porse duhet të jesh edhe i bindur për to. Pikërisht në lidhje me këtë, apostuli na udhëzon drejt botimit që do të dalë brenda një kohe të shkurtër „Katekizmi i Kishës Apostolike të Re në Pyetje dhe Përgjigje“, i cili pasqyron në mënyrë më të qartë mësimin tonë.

Me atë botim të parashikuar të „Katekizmi i Kishës Apostolike të Re në formën e Pyetje dhe Përgjigje“ (KNK PP) të vitit 2015, kemi në dispozicion dy forma të një vepre, të cilat përmbushin kërkesa të ndryshme.

Shumë shpejt mbas botimit të Katekizmit të vitit 2012 në gjuhët kryesore, pasuan shumë përkthime të tjera. Krahas daljes në shtyp, Katekizmi që gati edhe në formë elektronike. Përveç kësaj u përgatitën edhe versione për Internet. Sipas pulsit të kohës u zhvillua edhe „Katekizmi-App“ për Smartphones dhe Tablets. Nga përmbajtja të gjitha këto versione janë njëlloj.

Qe një dëshirë, një kërkesë e Apostulit kryesor Leber, që të punohej edhe një version i përshtatshëm i Katekizmit për qëllime mësimore. Ky duhet të shërbejë për të lehtësuar kapërcimin e lidhjeve pjesërisht të vështira. Botimi më i ri i Katekizmit në formën e Pyetje dhe Përgjigje plotëson drejtësisht këtë kërkesë. Për përpilimin e kësaj veprë u nda teksti i botimit të gjatë prej 750 faqesh të Katekizmit në formën e Pyetje dhe Përgjigje. Nëpërmjet një ndërtimi të lehtë e të kuptueshëm, kjo vepër mund të përdoret për shkollimin e vëllezërve të administratës në shkallë botërore si dhe për të dhënë mësim.

Përse në formën „Pyetje dhe Përgjigje“?

Skema Pyetje-Përgjigje është përdorur që prej shekujsh në Katekizmin e krishterë dhe ka edhe në kishën tonë një traditë të gjatë. Metoda didaktike që qëndron pas saj është provuar, kontrolluar shpeshherë. Ajo është përdorur prej një kohe të gjatë në mësimet e konfirmacionit. Kështu, në të ardhmen, KNK PP do të gjejë përdorim si një vepër mësimore shoqëruese. E mbi të gjitha ai është i përshtatshëm për ta transmetuar më dukshëm mësimet kristiane në përgjithësi dhe mësimet e kishës sonë në veçanti.

Nxitur nga apostuli kryesor Leber „Katekizmi i Kishës Apostolike të Re në formën e Pyetje dhe Përgjigje“ u provua apo kaloi një fazë testimi, i cili u dha udhëzime të rëndësishme projekt-grupit të ngarkuar për përpilimin e tij. Paraprakisht u punuan shkëlqyeshëm tri kapituj në formën e Pyetje dhe Përgjigje dhe u testua në mësimin e konfirmacionit. Testet u kryen në Afrikë, aty ku banojnë shumica e anëtarëve të kishës.

Gjatë përpilimit të veprës iu kushtua një vëmendje e rëndësishme lexueshmërisë. Në këtë mënyrë teksti përmban shumë citate të plota biblike. Ata i ofrojnë lexuesit përparësinë, që edhe më pas të mund ta lexojnë atë në Bibël, nëse nuk e kanë atë prezent. Kjo është menduar pikërisht për ato vende, ku jo secili zotëron një bibël. Kështu kjo vepër nuk i shërben vetëm njohjes së mësimëve tona të besimit, por mbi të gjitha ofron edhe një përmbledhje të mirë rreth atyre thënieve të Shkrimit të Shenjtë kaq të rëndësishme për mësimet e besimit.

Definicionet, që nuk janë të kuptueshme për të gjithë, do të sqarohen në detaje aty ku ato përdoren për herë të parë. Me qëllim që ta përdorim këtë vepër të kombinuar me KNK,

ndërtimi përkatës i saj i përshtatet strukturës së KNK. Kështu që „Katekizmi si Pyetje dhe Përgjigje“ mund të përdoret edhe si „Libër pune“ për Katekizmin. Në këtë mënyrë ai i shërben edhe qëllimit autodidakt, për ta studiuar vetë përmbajtjen e Katekizmit.

Qëllimi kryesor gjatë përpilimit që arritja për të siguruar një kuptueshmëri dhe perceptim maksimal. Për ta arritë këtë, u përdorën mjete të shumta:

- Nëpërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve të cilat ngrihen, ndërtohen mbi njëra-tjetrën, lexuesi merret pothuajse përdore dhe drejtohet tek përmbajtja
- Që lexuesi të mund të futet me lehtësi në përmbajtjet pjesërisht komplekse, temat janë të ndara në pjesën më të madhe të tyre nga pyetje dhe përgjigje të veçanta. Kështu mund të mbahen shkurtimisht pjesët kuptimore.
- Teksti është formuluar në mënyrë tërheqëse, mundësisht pa përdorur terma teknike.
- U mënjanua, çdo mënyrë e veçantë mendimi, e cila të çon në interpretimin deri në detaje të deklaratës së përshtatshme doktrinare.
- Për definicione të caktuara janë marrë sqarime, e përkatësisht ato që janë më të zgjeruara në krahasim me KNK.

Fotot e përzgjedhura të ftojnë drejt përmbajtjes. Pjesërisht ato nënvizojnë tekstin, të cilave ato u përkasin dhe pjesërisht shërbejnë thjesht për ilustrim. Kështu edhe imazhet e printuara bëhen më tërheqëse, gjë që ndikon në një lexim më të mirë.

Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider, i cili ka shoqëruar intensivisht procesin e kryerjes së KNK në formën e Pyetje dhe Përgjigje, i drejtohet lexuesit të veprës me fjalët që vijojnë:

„Ashtu si KNK, edhe ky version i Katekizmit është një thirrje drejtuar kristianëve apostolikë të rinj, që të merren apo angazhohen më intensivisht me përmbajtjen e besimit të tyre. Gjithashtu ai fton të gjithë të interesuarit, të njohin teorinë e besimit apostolik të ri. Uroj që kjo vepër të shërbejë për një përdorim të bekuar!“

Imprint

Publikues: Jean-Luc Schneider,
Überlandstrasse 243, CH-8051 Zurich, Switzerland
Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH
Gutleutstrasse 298, 60327 Frankfurt/Main, Germany
Editori: Peter Johanning




Foto: Oliver Rütten

Kapitulli 1: Zbulesat e Perëndisë

„Katekizmi i Kishës Apostolike të Re në formën Pyetje dhe Përgjigje“ është përpunuar në formën metodologjike dhe didaktike. Me anë të 750 Pyetjeve dhe Përgjigjeve, lexuesi si të themi kapet prej dore dhe drejtohet drejt një kuptimi më të lehtë nga thënia në thënie.

Ku është prejardhja e besimit të Perëndia?

Prejardhja e besimit është te vetë Perëndia. Ai bëhet i njohur para njerëzve: Ai „u shfaqet“. Njohurinë, për të kuptuar se Zoti ekziston, ia ka dhuruar vetë ai. Zoti nuk fshihet, por lejon të njihet nga njerëzit, me qëllim që njerëzit të flasin për të dhe të kenë besim tek ai.

„ sepse, ajo që mund të dihet për Perëndisë, është bërë e dukshme në ta (në njerëzit); sepse Perëndia ua ka shfaqur atyre. Pasi natyra e tij e padukshme, fuqia e tij e përjetshme dhe hyjnia e tij, duke qenë të dukshme nëpërmjet veprave të tij, që nga krijimi i botës, shihen qartë, me qëllim që ata të jenë të pashfajësueshëm.“
Rom 1,19.20

Si shfaqet Perëndia?

Perëndia shfaqet në mënyra të ndryshme, në natyrë dhe në histori.

Si shfaqet Perëndia në natyrë?

Zoti shfaqet në natyrë si krijuesi: në ekzistencën e universit, njeriut, kafshëve dhe bimëve.

„Nga dhomat e sipërme të tij ai u jep ujë maleve; toka ngopet me frytin e veprave të tua. Ai bën që të rritet bari për bagëtinë dhe bimësia në shërbim të njeriut, duke nxjerrë nga toka ushqimin e tij ...“ Psalmi 104,13.14

Si e shfaq veten Perëndia?

Perëndia është një qenie Shpirtërore. Ai e shfaq veten si një Zot,

- Ati, krijuesi dhe ruajtësi i krijimit (Zanafilla 1,1; Zanafilla 8,21.22),
- Biri, çliruesi dhe shpëtimtari (1. Gjoni 5,20),
- Shpirti i Shenjtë, ngushëlluesi, që çon në çdo të vërtetë (Gjoni 16,13).

Ku janë të shkruajtura zbulosat e Perëndisë?

Zbulosat e Perëndisë janë të shkruajtura në Shkrimin e Shenjtë. Nën „Zbulosat e Perëndisë“ kuptojmë shumë gjëra:

- Perëndia lejon të njihet. Ai jep shpjegim mbi natyrën e tij („Vetëzbulosat“ e Perëndisë).
- Zoti ja u bën të qartë njerëzve vullnetin e tij.
- Perëndia e takon njeriun në dashurinë e tij, veçanërisht në fjalën dhe shenjtërimet e tija.

A ka njohuri të tjera rreth veprimit të Zotit?

Po, me anë të veprimit të Shpirtit të Shenjtë në postin e apostujve, dhurohen njohuri dhe vështrime mbi veprimin e Perëndisë për shpëtimin e njerëzve. Në bibeël këto janë treguar dhe zbulohen më tej me anë të Shpirtit të Shenjtë

Si duhet të sillet njeriu ndaj shpalljeve të Perëndisë?

Njeriu duhet të besojë në Zot dhe në zbulosat e tij. Vetëm nëpërmjet besimit njeriu percepton, kupton zbulosat e Perëndisë. Nëse ai beson, atëherë do të jetë e vlefshme për të dhe do të dominojë jetën e tij gjithçka hyjnore. Për dikë që nuk beson, se Perëndia është Krijuesi i gjithçkaje, ai nuk beson p.sh. se Kozmosi Ëeltall nuk është vepër e tij, ku Zoti na shfaqet si Krijues, porse është rezultat i proceseve të rastësishme të natyrës.

Si arrin njeriu të besojë?

Besimi na dhurohet e na fuqizohet nëpërmjet Shpirtit të Shenjtë. Kjo ndodh ndër të tjera nëpërmjet predikimit të Ungjillit bazuar mbi Shpirtin e Shenjtë.

„Kështu, besimi vjen nga predikimi, ndërsa predikimi nga fjala e Krishtit.“ Rom. 10,17

Çfarë është Bibla?

Shkrimi i Shenjtë – Bibla – është një përmbledhje e shkrimeve që flasin rreth veprës së Zotit, premtimeve dhe urdhërësive (ligjeve) të tij. Ajo përbëhet nga Testamenti i Vjetër dhe nga Testamenti i Ri. Shkrimi i Shenjtë dëshmon rreth zbulësive të Perëndisë, e megjithatë ajo nuk është një raportim krejtësisht i plotë dhe pa asnjë mungesë i të gjitha veprave të tij. Perëndia është kujdesur që të mbesë deri tani, gjë që është e rëndësishme për shpëtimin e njerëzimit. „Bibël“ rrjedh nga fjala latine „biblia“ dhe do të thotë „Libra, Buchrollen“.

Cili është autori i Shkrimit të Shenjtë?

Autori i Shkrimit të Shenjtë është Zoti. Njerëzit, të cilët u nxitën, u inspiruan nga Shpirti i shenjtë, kanë shkruar atë që zoti shpallte. Përsa i përket formës dhe mënyrës së zë shprehurit, librat biblik janë ndikuar nga autorët përkatës dhe sipas imagjinatës së tyre si dhe eksperiencës së asaj kohe.

„Inspirim“ do të thotë e përkthyer: „frymëzim, frymëmarrje e“.
Inspirim hyjnor do të thotë, që Shpirti i Shenjtë nxit, frymëzon njeriun e pikërisht i transmeton diçka atij.

A janë transmetuar besueshëm tekstet e librave biblikë?

Po, Perëndia është kujdesur, që tekstet e librave biblikë të mbeten të pafallsifikuara gjatë shekujve.

Si u arrit, si u bë e mundur mbledhja e librave biblikë?

Mbledhja e librave biblikë ndodhi gjatë shekujve. Ajo rrodhi falë jo vetëm konsideratave njerëzore, por para së gjithash edhe falë vullnetit të Perëndisë. Kanuni i krishterë i Testamentit të Vjetër bazohet në Kanunin hebraik të Judaizmit, shkrimet e të cilit u krijuan gjatë një periudhe prej ndoshta 1000 vjetësh.

Një pioner bëhet ndihmës-apostul distrikti

„Me gjithë zemër apostolik i ri“, kështu e përshkruan një shoqëruese apostulin João Uanuque Misselo. Më 22 Shkurt apostuli kryesor Jean-Luc Schneider e ngarkoi atë me detyrën e ndihmës-apostulit të distriktit për Angolën. Rast për një udhëtim të shkurtër nëpër kohë dhe vend.



ndihmuar në ndërtimin e punës së kishës apostolike të re në Angola.

Një rritje e vazhdueshme

„Në fillim qenë vetëm dy besimtarë“, tregon për fillimet e punës, apostuli i distriktit tashmë në pension Brinkmann: „Dhe tre dekada më vonë bëhen gati 250.000 besimtarë apostolikë të rinj.“

Nuk është për t'u çuditur: Besimtarë me një besim të thellë takuan pionierët e kishës apostolike të re. Në fund të fundit Angola bën pjesë ndër vendet me një traditë të madhe kristiane. Para 500 vjetësh Portugalia e kolonizoi dhe e ungjillizoi këtë vend të Afrikës Perëndimore. Pak nga pak çdo fshat kishte kishën e vet dhe kisha katolike u fut në të gjithë sistemin shkollor.

Edhe besimi apostolik i ri u prit me krahë hapur. Kështu na tregon apostuli i distriktit Brinkmann mbas një udhëtimi që bëri në Angolën Lindore, në Gusht 1985: „Kur ne arritëm atje, kemi mbajtur shërbesa fetare më shumë se nga një orë. Gjith-



Iart: Apostul Misselo përshëndetet nga fëmijët e bashkësisë

Shoqëruesi më i përshtatshëm për një udhëtim nëpër historinë e vendit është apostuli i distriktit Armin Brinkmann. Ai vërtet është në pension tashmë, por ai jo vetëm ka shoqëruar João Uanuque Misselo

në të gjitha detyrat e ngarkuara, që prej asaj si diakon (1985) e deri si kryeplak i distriktit (1994), por mbi të gjitha, ai ka

djathtas: Apostuli i distriktit Rainer Storck me apostujt e zonës së punës së tij, Vestfalia e Rinit verior dhe Angola. Poshtë: Përshtypje nga takimi i apostujve në Angola



Foto: NAK Nordrhein-Westfalen

një e më shumë shtoheshin njerëzit, dëgjonin, pagëzoheshin dhe merrnin vulën e shenjtë.“

Rreziqet dhe pengesat

Qe një udhëtim me shumë pengesa: „Kufijtë qenë të pakalueshëm; lufta civile qe e pranishme në jetën e përditëshme deri në 2002.“ Me gjithë këto situata kaotike, evangjelisti i distriktit i atëhershëm Manuel Eduardo Mbuta arriti të gjejë për ne dy bileta avioni. Dhe rruga për te motrat e vëllezërit e ardhshëm u hap.

Nuk qenë vetëm kohë aventureske, porse edhe të rrezikshme: Kështu më 1989 ranë pre e rebelëve në veri të vendit apostulli Brinkmann dhe katër vëllezër të tjerë administrate. Në këtë sulm vdiq, për shkak të plagëve të rënda, apostuli i pare për këtë vend.

Angola hyri në një faze tjetër

Por edhe kjo humbje e dhimbshme nuk i dekurajoi vëllezërit e administratës në punën e tyre. Numri i bashkësive dhe i anëtarëve të kishës u rrit vazhdimisht. Më 2005 u bë e nevo-

jshme një drejtim shtesë në Angolë. Që nga ajo kohë koordinojnë punën e kishës apostolike të re në rajone të ndryshme të vendit të ashtuquajturit „Lead-Apostles“, Manuel Eduardo Mbuta, João Uanuque Misselo dhe Alfonso Avelino. Sot punojnë atje 15 Apostuj dhe 10 Bishopë të cilët kujdesen për të krishterët atje, pasi përbëjnë më shumë se 2200 bashkësi. Dhe kjo rritje vazhdon të qëndrojë.

Ngarkimi në detyrë i një ndihmës-apostuli të distriktit

Pak kohë edhe për këtë fazë: Më 22 shkurt apostuli kryesor Jean-Luc Schneider vizitoi kryeqytetin Luanda dhe vendosi në detyrë një ndihmës-apostul distrikti për Luandën. Njeriu i duhur për këtë detyrë është sot për sot, kështu thotë apostuli aktual i distriktit Rainer Storck, ky është apostuli Misselo: „Ai e njuh mirë të gjithë vendin dhe është një kujdestar i mirë shpirtëror. Paraqitet ashtu thjeshtë, por di se çfarë kërkon.“

Dhe horizonti i tij i kapërcen kufijtë e vendit të tij, shton edhe mbartësi i mëparshëm i bekimeve Brinkmann: „Mëson anglisht!“ ka inkurajuar në atë kohë të gjithë vëllezërit portugalisht folës të Angolës. „I vetmi që ka mundur të punojë në atë kohë qe João Uanuque Misselo.“ Kjo ia mundëson atij punën në grupin e punës për Afrikën dhe në grupet e tjera ndërkom-bëtare të punës.

Ngarkimi me detyrën e ndihmës-apostulit të distriktit është një vendim i drejtë dhe i suksesshëm për kishën në rritje në Angola, thekson apostuli i distriktit Rainer Storck: „Apostel Misselo nuk është as 50 vjeç. Ky qe një vendim i drejtë për të ardhmen.“

Takimi i feve të ndryshme jep një shembull

Një takim jo i zakonit por në një kohë të veçantë: Klerikë të rangut të lartë të feve të ndryshme mundën të takoheshin në shërbesën fetare të Kishës Apostolike të Re në Luksemburg rreth apostulit kryesor më 11 Janar 2015.

Para shërbesës fetare, miqve të nderuar iu urua mirëseardhja. Ndër ta bënte pjesë edhe Rabini i madh Alain Nacache nga Konsistoriumi izraelit në Luksemburg, Jean-Luc Karleskind si zëvendës president i bashkësisë myslimane në Großherzogtum dhe Jutta Bayani si kryetare e bashkësisë Bahai. Kisha katolike u përfaqësua nga Théo Péporté, përfaqësues i Erzbischofs, Christian Descoups, sekretar i përgjithshëm pranë Erzbistum, dhe Willy Fuchs, sekretar i përgjithshëm i aksionit të burrave katolikë. Aleancën evangjeliste të Luksemburgut e prezantuan Bishopi Adama Ouedraogo dhe Diakoni Fernand Gilles.

Shkak i pjesëmarrjes së tyre në shërbesën fetare u bë një ftesë mbresëlënëse, e cila ishte bërë muajt e fundit për një bashkëpunim të një niveli politik. Kjo u bë edhe shkak që apostuli përgjegjës edhe për Luksemburgun Clément Haeck, t'i japë përgjigje redaksionit të Community. Regjimi i atjeshëm punon e sulmon për një ndarje të fortë të shtetit nga feja, nga besimi. Në këto debate lindën edhe kontrata shtetërore, si për shembull ato rreth rregullave të reja për ndihmë financiare.

Në këtë mënyrë, përfaqësues të bashkësive të ndryshme besimtare u përpoqën shumë për të reformuar mësimin e deri-

tanishëm të fesë, i cili jepet nëpër shkolla. Ata vendosën për një mësim feje, i cili krahas etikës neutrale të fesë të mund të transmetonte edhe njohuri të shumta rreth pohimit, dëshimit të besimeve të ndryshme. Ndër ata që nënshkruan për një angazhim më të dukshëm të regjimit, bën pjesë edhe kisha apostolike e re. Në këto biseda njohëm më mirë njëri-tjetrin, tregon Apostul Haeck. E kështu lindi mendimi të ftojme në shërbesën fetare të apostulit kryesor edhe partnerët tanë.

Ajo që nuk mund të parashikohej në atë kohë, qe vetëm aktualiteti i veçantë, që ky takim i Religioneve të ndryshme do të merrte: pak ditë para shërbesës fetare, më 7 Janar, terroristët islamikë sulmuan zyrën e gazetës humoristike dhe një supermarketë çifute në Paris dhe vranë 16 njerëz të pafajshëm. Dhe pikërisht në ditën e shërbesës fetare, më 11 Janar, miliona njerëz me fe e besime të ndryshme demonstuan së bashku kundra terrorizmit dhe armiqësisë ndaj të huajve.

Për këtë shkak apostuli kryesor Jean-Luc Schneider e vlerësoi shumë dhe i dha një rëndësi të madhe ardhjes së miqve të nderuar. Këtë gjë ai e theksoi edhe një herë në takimin që pati me ta mbas shërbesës fetare. Ai i falenderoi për prezencën e tyre dhe premtoi solidaritet me të gjitha viktimat e racizmit dhe intolerancës, qofshin ata judë, myslimanë apo të krishterë.



Apostul Clément Haeck (i pari majtas), Apostuli kryesor Jean-Luc Schneider (i shtati djathtas) dhe apostuli i distriktit Bernd Koberstein (i treti nga e djathta) me miqtë e nderuar mbas shërb. fet

Të reja nga Shqipëria

Motra jonë Sofika Rako ndërroi jetë

Ditën e Premte, më 8 Maj 2015, me të vërtetë në një ditë të bukur pranvere, ne morëm lajmin e hidhur se: Sofika, nëna e evangelistit tonë Alfred Rako, ndërroi jetë në moshën 72 vjeçare.

Vdekja e përfshiu atë krejtësisht papandehur. Ajo ishte në oborrin e shtëpisë, ndjeu dhimbje në kraharor dhe mundi të thërrasë vetëm „Fiona“, mbesën e saj dhe më pas u rrëzua për tokë dhe ndërroi jetë.

Jo vetëm familja e saj e ngushtë, por edhe miq e të njohur u shokuan dhe u dëshpëruan shumë.

Me qenë se një pjesë e familjes së saj banon në Amerikë, si vajza e saj Marika me burrin e me mbesën dhe nuk mundën të vijnë më përpara se sa dita e Dielë në mesnatë, ceremonia mortore u la për ditën e Hënë më 11 Maj.

Në orën 12 të drekës u mbledhën përpara shtëpisë së saj të bukur në qendër të Tiranës shumë njerëz, me të cilët Sofika kishte qenë e njohur, dhe më pas në një autokollonë prej dy autobusash e veturash private udhëtuan drejt varrezave.

Atje u mbledhëm të gjithë me respekt të madh rrotull arkivolit të motrës sonë Sofika. Apostul Gamov bëri një lutje dhe dha mendimin e vet për kufizimin e kohës së jetës sonë këtu në tokë si dhe për kalimin e shpirtit dhe për jetëgjatësinë e tij në botën e përtejme; po në këtë mënyrë foli edhe kryeplaku ynë i distiktit Rafaeli; një kushëri i burrit të Sofikës, Stefan, foli për të, duke përmendur në veçanti fëmijët dhe mbesat e saja, për të cilat është kujdesur aq shumë për sa kohë jetoi. Më në fund arkivoli iu la tokës dhe Apostuli tha fjalët „dheu tek dheu, pluhuri tek pluhuri“,

sipas traditës së krishterë dhe hodhi i pari dhe mbi arkivol. Mbas varri u mbulua, u vendosën mbi të lule të ndryshme, të sjella nga bashkësia, nga familjarë e të njohur. Më në fund, apostuli bëri edhe lutjen e fundit.

Motra jonë Elsa Rafaeli citoi pranë varrit të Sofikës nga teksti i këngës Nr. 437 „Ashtu sikurse yjet vezullojnë“ – refrenin e mrekullueshëm: Një gjë veç mbetet, kurrë nuk tretet, ajo që ti me dashuri për ne ke bërë Ja, kështu është!

Sofika pati një jetë të pasur, ka bërë shumë në jetën e saj familjare dhe të punës në shkollë. Të gjithë ata që e njohin, e dinë, se ka qenë një grua shumë e fortë, e cila e humbi bashkëshortin e saj shumë herët dhe iu desh të luftonte shumë në jetë.

Ne e falenderojmë atë për gjithçka të mirë dhe të dashur që ajo ka bërë për sa kohë jetoi dhe do të ruajmë për të një kujtim të nderuar dhe të dashur.



Vendi ku ajo prehet

Pashkë të gezuara në Shqipëri - Inagurim i kishës apostolike të re në Lushnjë

Si ne mbare boten Apostolike edhe ne Shqipëri u festua me gezim shume te madh dita e Ringjalljes së Jezu Krishtit. Besimtarët Apostolike ne Shqipëri e Kosove ishin pergatitur per kete ngjarje te madhe, ku fitorja mbi vdekjen dhe zbritja e Shpirtit te Shenjte, nepermjet sakrifices se Jezu Krishtit, i bashkoi kete mengjes ne 5 Prill 2015 plot shprese e gezim.

Plot 195 vellezer e motra, Apostolike te distriktit te Shqiperise e Kosoves, si dhe miq e te ftuar heret ne mengjes u drejtuan per ne shtepine e zotit, per te marre nga vellezerit e administrates sherbimin dhe fjalën e marre nga bible, por dhe per te festuar premtimin e ardhjes te Birit te vetem te Perendise. Ishin keto

Bashkësia e Lushnjës



Foto: NAK Shqipëri

motive qe e bene kete dite plot mall e dashuri, plot falje e pajtim, plot mbresa e perjetim, ku sejcili sillte perpara altarit te shenjte gezimin e jetes se vet, gezimin e nje jete me shprese e premtim. Ambienti festiv i kesaj dite ne te gjitha bashkesite motivoi edhe femijet e te rrinjte te jepnin koncerte me pjese muzikore, kenge e recitime nga libri I kengeve te kishes sone, ku nepermjet tyre ndjeme sa bukur eshte t'i kendosh dhe te adhurosh dashurine e perendise.

Ja pra, kur vullneti e besimi ecin te sigurte ne boten e femijes ke se cfare te presesh per te ardhmen ne rrugen tende te besimit, ne rrugen tende drejt shpetimit, ne rrugen tende drejt mijevjecarit te ri te premtuar. Kjo eshte dita qe na jep me shume shprese, me shume dashuri, me shume siguri dhe premtim. I dashur vella e moter Apostolike merre, mbaje fort perdore mire Pashkën - aakrificën qe Jezusi beri per ty e per mua, per gjithë popullin e zotit, duke na dhene clirim e shpetim te perjetshem.

Ne mesditen e 5 Majit, ora 12.00 u inagurua Kisha Apostolike e Re ne Lushnje. I ngarkuar nga Apostuli Otten, Kryeplaku I Kishes se bashku me sherbimin e dites beri edhe Shenjterimin e kesaj shtepie zoti. Ne kete sherbese e shenjterim te ketij ambienti moren pjese 28 motra e vellezer, miq e te ftuar, moren pjese edhe te gjithë vellezerit e administrates se kishes Apostolike ne Shqipëri. Tashme vellezerit e motrat e bashkesise Lushnje do te kene shtepine e tyre te besimit ne nje ambient dinjitoz, ashtu si jemi ne Apostoliket e ri, si eshte kisha dhe besimi yne. Se bashku me ambientet e salles se kishes, dhomes se vellezerve, ne do te kemi edhe nje ambient per femijet e moshes 2-6 vjec, pra, nje kopsht femijesh me kapacitet deri ne 30-femije.

Ishte vullneti e deshira e Apostul Otten qe te jepte mundesi financiare per restaurimin e ketyre ambienteve qe do te sherbenin per te gjithë motrat e vellezerit apostolike ne Lushnje.



Foto: NAK Shqipëri

Bashkësia Kuçovë gjatë festimit të Pashkëve

Tashme na mbetet ne, vellezerve te administrates, te punojme me shume per te thirrur e afruar sa me shume miq e te ftuar, pra te kemi sa me shume pjesemarrje si ne sherbese fetare ashtu edhe ne frekuentimin e kopshtit. Perëndia, nepermjet Apostulit Otten, e beri punen e saj, tashme na mbetet ne te tregojme sa te vullnetshem jemi per t'i sherbyer Perendise. Une jam i bindur se ky vullnet nuk i mungon asnje prej vellezerve tane te administrates, si dhe motrave dhe vellezerve te tjere per te dhene kontributin e tyre atje ku ka nevojë.

| Të reja nga Kosova



Apostul Otten në Pejë

Mbresa nga udhëtimi i shërbimit në Kosovë 17-19 Prill 2015

Ishte shumë heret në mëngjes në Kucovë, ora 4.30, kur u nisa me gezim të madh për një udhëtim i cili ishte planifikuar muaj më parë. Ora 6.30 minuta mbrita në Tiranë ku me priste moter Natasha. Te dy se bashku do të udhëtonim drejt aeroportit të Prishtinës. Duhej që të arrimim atje rreth orës 11.30. Kështu na u desh të udhëtonim rreth 4 ore pa ndalesa për të mbritur në kohe.

Avjoni me të cilin do të vinte Apostul Otten mbrinte në orën 11.55 minuta. Gjate udhëtimit me moter Natashën bisedonim se si mund të ndërtonim punën tonë së bashku me të gjithë vellezerit e administratës për t'i shërbyer sa më mirë vellezerve e motrave tona të besimit në Shqipëri e Kosovë. Ora 9.00 kaluam doganën e Morinës dhe udhëtonim drejt Prishtinës.

Pa pritje lexojmë tabelën e aeroportit Adem Jashari Prishtinë. Ora ishte 11.00. Pra ishim në kohe, Gezimi I këtij udhëtimit kishte cvluresuar kilometrat e Kohen. Rreth orës 12.15 avjoni, të cilin në prisnim, bëri uljen. Gjate pritjes në aeroport blenë 3 byreke të Kosovës, sepse prisnim kësaj rradhe 3 mysafire nga Gjermania, prisnim Apostul Otten dhe dy djemtë e tij David e Ben.

Udhëtarët filluan të dilnin dhe dalluam midis tyre tre trupa të gjatë me fytyra të qeshura. U përshendetëm duke u perqafuar dhe zhvilluam një bisedë të shkurtër për udhëtimin e tyre. Sipas traditës së Shqiptarit I ofruam byreke për Kosovë dhe ujë. I pranuan me kënaqësi dhe I pelqyen shumë, ky ishte kontakti I parë me këta djem të rrinj të thjeshtë e shumë të dashur.

Nisemi drejt Pejës dhe makinën e drejton Apostul Otten. Gjate udhëtimit Apostul Otten u interesua për vellezerit e administratës së Shqipërisë sidhe për vellezerit e motrat e cdo bashkësie. Me pas na prezantoi dy djemtë e tij, moshën dhe studimet e punën e tyre. Djali i madh Davidi kishte studjuar për media dhe punonte së bashku me të atin në firmë. Ai ishte edhe diakon në bashkësinë e qytetit të lindjes. Beni, djali I dytë kishte studjuar në Berlin Ora 18.00 mbrinte në Pejë dhe akomodohemi në hotel Dukagjini.

Rreth orës 19.00 shkojmë për darke dhe biseda vazhdon mbi organizimin e bashkësisë, shërbesat fetare, punën e vellezerve të administratës, organizimin e shërbesës të dt.17 Maj, që do të organizohet vecanerisht për miq e të ftuar në të gjitha bashkësitë e Shqipërisë sidhe vizitën e Apostulit Kryesor që do të zhvillohet në muajin Korrik 2016 në Shqipëri.



Apostul Otten me vëllezërit administratë në Pejë

Te nesermen para dite zhvilluam disa vizita ne qytetin e Pejes, Gjakoves, Prizrenit. Mbas dite ora 19.00 u takuam me vellezerit e administrates se Pejes Priftin Valdet Kryeziu dhe diakonin Korab Kryeziu.

Apostul Otten zhvilloi oren e vellezerve ne zyren e kishes ne Peje. Fjala u mor nga Bibla si dhe nga seminari ai foli rreth shenjterimeve.

Ne fund te kesaj ore vellezerish Apostul Otten bisedoj mbi aktivitetin e bashkesise se Pejes, per vellezerit e motrat e besimit Apostolik te Pejes, per pjesemarjen dhe vizitat ne familje.

Bashkësia e Pejës



Foto: NAK Kosovë

aeroportit te Prishtines, ndahemi me ta me kenaqesine e ketij udhetimi dhe me falenderimin qe Kisha jone, pra Kisha Apostolike e Re kishte bere e investuar per bashkesine dhe vellezerit e motrat e Pejes.

Por edhe me premtimin se ne nje kohe shume te afert keta djem te shkelqyer do te vijne te vizitojne Shqiperine bashkesite tona dhe do te takohen me vellezerit e motrat e besimit ne Shqiperi. Perqafohemi me shume dashuri me Davidin e Benin dhe nisemi per Shqiperi.

Apostul Otten, Kryeplaku dhe moter Natasha mbrijme ne Tirane, mbas kater ore udhetimi, rreth ores 20.00. Nga ky udhetim Apostuli zhvilloi te nesermen nje takim te shkurtet me vella Fatmirin, rreth kopshtit te ri per qytetin e tiranes.

Biseda qe intensive dhe plot detyra te reja.

Apostuli, si gjithnje i palodhur, u shoqerua per ne aeroportin Nene Tereza nga moter Natasha dhe vella Eltoni. Edhe gjate kesaj rruge Apostuli kujtonte vazhdimisht detyrat qe duhet te permbusheshin nga vellezerit e administrates dhe me ndihmen e Zotit deri sa ait e vinte perseri ne Qershor te po ketij viti.

Me diakon Korabin u zhvillua biseda per organizimin e puneve ne kopshtin e Pejes, per frekuentimin e femijeve, programin mesimor, shpenzimet dhe rezultatet e ketij aktiviteti. Te nesermen dt 19 Maj, ora 10.00 u zhvillua sherbesa fetare nga Apostul Otten me fjalen e marre nga bibla.

I dyti sherbeu Kryeplaku I distriktit per Shqiperine e Kosoven Andrea Rafaeli. Ne kete sherbese fetare moren pjese 9 vellezer e motra te besimit.

Mbas sherbeses, Apostul Otten, Kryeplaku dhe dy djemte e ardhur nga Gjermania te shoqeruar nga Prift Valdet Kryeziu, Diakon Korab Kryeziu dhe moter Natasha vizituan ambientet e kopeshtit te femijeve Peje, investim I Kishes Apostolike te Re Gjermani. Vertet kushte dhe ambiente shume te mira per femijet e qytetit te Pejes por edhe kushte shume te mira per punonjesit qe sherbejne ne kete aktivitet te Kishes sone.

Mbasdite rreth ores 14.00 percjellim dy miqte e rinj drejt



Foto: NAK Kosovë

Kopshti i fëmijëve Pejë



Informacione rreth
Shërbesës fetare të
Pentakostit
në Zambia në

nac.today

Foto: Pentakosti 2014 në Gjermani

New Apostolic Church
International

